



## Bibliografia analitike albanologjike

Alda Biçoku

Principal Bibliographer, Department of Albano-Balkanology, National Library of Albania, Tirane, Albania

### Abstract

Bibliografia analitike albanologjike, duhet të bazohet në njësi të shkruara që kanë një informacion të bollshëm mbi historinë, prejardhjen, gjuhën, etnologjinë, gjeografinë, antropologjinë, problemet sociale e zakonore, marrëdhëniet etnike, marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare, çështjen e kufijve, fenë etj. për Shqipërinë dhe shqiptarët. Ajo duhet të jetë një vepër shkencore me informacion të pasur bibliografik dokumentar dhe shënime analitike mbi materiale të botuara apo të dorëshkuara nga studiues të shumtë në qarqe shkencore e kulturore të botës antike, mesjetare dhe moderne.

Në këtë artikull do të trajtohen mënyra e hartimit të bibliografisë analitike albanologjike. Mendoj se veprat që mund të përfshihen në një bibliografi analitike albanologjike duhet të jenë selektive, dhe të listohen e analizohen ato njësi që plotësojnë kriteret e studimeve albanologjike. Në këto bibliografi njësitë duhen të përshkruhen *de visu*, që do të thotë jo nga burime të tërthorta, por drejtpërsëdrejti nga botime të shqyrtuara e të regjistruara.

Metoda e përdorur është analiza dhe përshkrimi, ndërsa materialet e shfrytëzuar janë vjelë nga njësitë librare me përmbajtje albanologjike.

**Keywords:** bibliografi, albanologji, përshkrimi bibliografik, adnotimi (adnotum)

### 1. Introduction: Hyrje

Veprat e regjistruara në një bibliografi analitike albanologjike duhen studiuar hollësisht dhe të paraqesin në një mënyrë të sistemuar kronologjike studimet më të rëndësishme shkencore albanologjike të shekujve XV- XX, në mënyrë që hulumtuesit e fushave albanologjike të marrin informacion dhe të kenë mundësinë e konsultimit të këtyre njësive me vlera të çmuara për të gjithë ata që duan të studiojnë historinë, gjuhën dhe kulturën e popullit shqiptar dhe të paraardhësve të tyre, ilirëve. Bibliografia duhet të përfshijë, si vepra autorëve të huaj ashtu edhe shqiptarë të cilët shkruan në shqip dhe në gjuhë të huaj dhe i botuan veprat e tyre jashtë trojeve shqiptare. Këto vepra dëshmojnë se shqiptarët me historinë, me gjuhën dhe kulturën e tyre, kanë patur rolin e tyre në qytetërimin evropian. Bibliografia analitike albanologjike duhet të ketë ambicjen të përshkruarit në tërësi të njësive që gjenden në koleksionet e trashëgimisë kulturore në institucionet e kujtesë kombëtare si: Biblioteka, Arkivi dhe Muzeu.

Në periudhën që po jetojmë, ku informacionit të saktë, të sistemuar e të verifikuar, u shtohet gjithnjë e më shumë vlera, hartimi i një Bibliografite analitike ka një rëndësi të veçantë.

Bibliografia analitike albanologjike duhet të jetë një vepër shkencore dokumentare me shënime dhe me informacion të pasur historik e filologjik. Studiuesi duhet të gjejë njoftime për vendin, kohën e botimit dhe autorin, numrin e ekzemplarëve të gjetur, vendin ku gjendet origjinali, kur është bërë ndonjë botim filologjik kritik për të, vepra është origjinale apo përkthim, ç'përmbajtje ka, me ç'alfabet është shkruar, ç'të dhëna jep parathënia apo pasthënia, në ç'gjendje fizike ruhet libri apo dorëshkrimi etj. Vepra, pra duhet të ketë karakterin e një enciklopedie të përmbledhur.

Po të përdorim terminologjinë profesionale të FRBR (*Functional Requirement for Bibliographic Record- Kërkesat Funksionale të Përshkrimit Bibliografik*)<sup>1</sup> elementi kryesor i përshkrimit është burimi bibliografik libror, i cili në këtë rast duhet të nisi nga më i vjetri, pra nga incunabula, antikuari apo dorëshkrimi, si shprehje apo manifestim i një veprë albanologjike. Bibliografia albanologjike e adnotuar duhet të paraqitet si një rreshtim regjistrimesh, të cilat përfaqësojnë vepra të veçanta që përmbajnë të gjitha elementët e të dhënave të nevojshme për një përshkrim bibliografik. Njësi bibliografike është një ekzemplar i vetëm i një manifestimi konkret apo shprehje e një veprë të një botimi monografik njëvëllimësh.

Të gjitha njësitë e manifestimit përmbajnë të njëjtin subjekt dhe janë identike në formën fizike, por mund të ndryshojnë nga njëra-tjetra si në rastin e një monografie të rilidhur nga biblioteka, siç ndodh me librat e vjetër të koleksioneve bibliotekare.

Në praktikën bibliografike botërore shpesh bibliografinë e analitike e trajtojnë si

- bibliografi e komentuar;
- bibliografi shtjelluese;
- bibliografi kritike;
- bibliografi vlerësuese;
- bibliografi e studiuar;
- bibliografi e adnotuar (*nga latinishtja adnotum*), etj.

Pavarësisht emërimit në këto lloj bibliografish dallohen dy pjesë kryesore, të cilat nuk mund të qëndrojnë pa njëra-tjetrën: Përshkrimi bibliografik i burimeve bibliografike dhe shënimi i

<sup>1</sup> Tillet, B. What is FRBR: A Conceptual Model for the Bibliographic Universe. Library of Congress Cataloging Distribution Servis, 2014.

cili në rrjetet shkencore bibliografike shpesh quhet adnotim (adnotum)

Identifikimi i botimeve, madje edhe i ekzemplarëve, përmes përshkrimit të detajuar dhe zbërthyes është qëllimi i çdo përshkrimi, për çdo njësi bibliografike. Lidhur me këtë, ka dy opinione, njëri është kopjimi me përpikmëri i të dhënave nga botimi që përshkruhet; tjetri, është zbatimi i rishikuar dhe i përmirësuar i struktues ekzistuese të ISBD- së (*International Standart Bibliographic Description - Standarti Ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik*). Por ka dhe raste kur ndiqet një përzjerje e këtyre dy mënyrave.

Si në çdo përshkrim bibliografik, edhe në rastin e botimeve të vjetra, bibliografia analitike është e detyruar të zbatojë rregullat dhe standardet përkatëse që janë:

ISBD(A) (*International Standart Bibliographic Description for Older Monographic Publications*), ISBD (*International Standart Bibliographic Description*)<sup>2</sup>, AACR2 (*Anglo-American Cataloguing Rules- Rregullat anglo-amerikane të katalogimit*)<sup>3</sup>.

ISBD(A)(*International Standart Bibliographic Description for Older Monographic Publications, Antiquaria*) është hartuar për përshkrimin e librave të vjetër në bibliografi apo për krijim baza të dhënash. Ky standart nuk është një grumbull rregullash për përshkrimin bibliografik, as nuk paraqitet si një tekst pëfundimtar për t'u përdorur në një bibliografi të adnotuar. Ai na jep variante e specifikime të ndryshme lidhur me elemente të tilla si pikësimi, botimi, shënimi etj. Por çdo agjenci bibliografike është e lirë që të bëjë adaptimin apo zgjedhjen e saj të varianteve.

Tipar i veçantë i standartit është se ai kërkon transkriptim të saktë të titujve, duke ndjekur rendin e faqes së titullit dhe kur është e mundur duke lejuar opsione për tërësinë e pikësimit. Qëllimi specifik i saj është të sigurohet një transkriptim plotësisht i saktë i faqeve të titullit e të mundësohet identifikimi i veprave dhe i botimeve të ndryshme të së njëjtës vepër.

Përshkrimi i librave të vjetër zakonisht formulohet për një qëllim disi të ndryshëm nga ai i regjistrimit të informacionit bibliografik të botimeve korente. Veçanërisht në këto bibliografi synohet që struktura e zërit bibliografik të jetë e përshtatshme dhe e dobishme për studiuesin, i cili kërkon një përshkrim të hollësishëm në një formë sa më të kuptueshme për një njësi nga një autor i caktuar ose mbi një temë të caktuar.

Në mjaft biblioteka të botës, librat e vjetër (pra librat deri në fillimin e shek. XIX ), konsiderohen si artefakte që duhen përshkruar në mënyrë të tillë që për arsye krahasimi të dallohen qartë nga kopjet apo botimet e tjera të të njëjtës vepër. Riprodhimet e faksimileve të këtyre botimeve zakonisht mbulohehen nga ISBD-të përkatëse për botimet moderne.

Por rregulli më i rëndësishëm është të shkruash se ç'farë sheh në burimin e informacionit.

Në përshkrimin bibliografik, librat e vjetër antikuar paraqesin

më tepër probleme, shpesh krejt të ndryshme nga ato të librave të zakonshëm.

- Titujt mund të jenë të gjatë dhe kompleks. Në shumë raste, rregullat e përshkrimit bibliografik sfidohen, në raste të tilla na vjen në ndihmë fryma e ISBD(A) (*International Standart Bibliographic Description for Older Monographic Publications (Antiquaria) - Standarti ndërkombëtar i Përshkrimit Bibliografik për Botimet e Vjetra Monografike, Antikuari*) dhe një gjykim i shëndoshë shkencor.

Faqja e titullit tashmë dihet që është burimi kryesor i informacionit. Por nëse një libër nuk ka faqe titulli, mund të përdorim: kolofonin, pjesët e tjera të shtypura të librit para tekstit (*verso* e faqes së titullit, kopertina), titullin e shkurtuar në fletën para faqes së titullit, informacionin e shtypur në pjesën e sipërme të çdo faqeje të librit, titulli vertikal, incipit, explicit, fjalët e nisjes së tekstit apo botimit dhe fjalët mbyllëse.

Pra bibliografi duhet t'i vërë veprës një titull, por të futur në kllapa katrore.

- Personat përgjegjës shkruhen siç jepen në burimin kryesor të informacionit. Kur më tepër se tre autorë kanë të njëjtin funksion, jepet vetëm emri i të parit i ndjekur nga ...[et al.] (*lat. et alii*, dhe njerëz të tjerë).

- Vendi i botimit shkruhet ashtu siç gjendet, nëse nuk ka emër shkruhet [s.l]. Emri i botuesit shkruhet si gjendet e nëse nuk ka një të tillë, shkruhet [s.n].

- Zona e botimit duhet të përmbajë një datë e nëse bibliografi nuk gjen një datë në njësinë që përshkruhet, ai duhet të hulumtojë më gjerë e ta vendosë vetë një datë në kllapa katrore.

Organizimi i punës për krijimin e një Bibliografie analitike duhet të nisë së pari me; përcaktimin e qartë të kriterëve të ndërtimit sipas subjektit të përcaktuar, kryerjen e kërkimeve bibliografike, vjeljen e njësive për temën e caktuar të bibliografisë që do të hartohet, përcaktimi i nivelit të standartit të përshkrimit bibliografik, kriteret e organizimit të lëndës dhe mënyra e organizimit të adnotimit (shënimit) për çdo zë bibliografik.

## 2. Modeli i adnotimit (shënimit)

*Në praktikën botërore njihen disa lloj adnotimesh që janë:*

a. **Adnotimi sqarues:** Ky lloj adnotimi është një lloj sinteze e përmbajtjes së veprës. Ai na jep një informacion të përgjithshëm për disa çështje të veprës e si të tilla mund të na shërbejnë titujt e kapitujve e të nënkapitujve.

b. **Adnotimi interpretues, kritik ose vlerësues:** Ky lloj adnotimi është jo vetëm një përmbledhje e shkurtër e veprës, por edhe një vështrim kritik dhe vlerësues për të. Nëpërmjet tij tregohet nëse vepra mund të jetë e dobishme apo jo në një fushë të caktuar studimi. Vlerësohet autori dhe vepra e tij mbi gjykimet apo tezat që hidhen në vepër. Shpesh jepet informacion i detajuar mbi background e autorit të veprës. A është i kualifikuar për të shkruar këtë apo atë vepër, çfarë mesazhi sjell, mbi ç'logjikë bazohet, ç'farë motivacioni ka, etj. Bëhen komente për rëndësinë e punimit për kohën, dobinë dhe efikasitetin e tij. Ballafaqohet vepra me veprat e tjera me të njëjtin subjekt apo të ngjashëm me të. Shihet me kujdes aparati informues bibliografik i vetë veprës (*shtojca*,

<sup>2</sup> International Standart Bibliographic Description for Older Monographic Publications (Antiquaria). Ed. By International Federation of Library Associations and Institutions, IFLA/Universal Bibliographic Control and International MARC Programme, Series 3.

<sup>3</sup> Welsh, A.; Batley, Sue. *Practical Cataloguing: AACR2, RDA and MARC 21*, Chicago: Neal-Schuman, 2012, xvi

*abstrakt, ilustrime, tregues, bibliografi*), e nëse janë a duhet të ishin.

Në këtë tip adnotimi shihet qartë gjykimi i autorit të bibliografisë. Kjo gjë e bën të dallueshme këtë lloj shënimi.

- c. **Adnotim informues-përshkrues:** Ky lloj adnotimi përshkruan shkurt nëse vepra është opo jo tërësisht për temën e bibliografisë apo trajton një aspekt të saj. Nxjerr shkurt qëllimi dhe argumentin kryesor të veprës. Evitohen opinionet personale të autorit të bibliografisë. Jepen disa karakteristika domethënëse të punimit si: ilustrime, statistika, referime, shtojca etj.
- d. **Adnotimi i kombinuar:** Ky lloj adnotimi kombinon brenda tij të gjitha modelet që përmendëm mësipër. Dhe pikërisht ky lloj adnotimi përdoret më shumë në bibliografitë e adnotuar.

### 3. Mënyra e të shkruarit

Mënyra e të shkruarit është element po aq i rëndësishëm në hartimin e adnotimit sa edhe përmbajtja e tij dhe ka të bëjë me mënyrën e të shkruarit të adnotimit.

Për këtë duhet të kemi parasysh:

- a. Adnotimi duhet të jetë sa më i përmbledhur dhe i veçantë. Jo më shumë se 100 fjalë. Duhet të evitohen fjalitë e gjata dhe fjalët e padobishme.
- b. Duhet përdorur i njëjti tip adnotimi dhe stili të shkruarit në të gjithë punimin.
- c. Adnotimi të bëhet në vetën e tretë.
- d. Të mos fillojë adnotimi me përsëritjen e informacionit eksplicit të titullit.
- e. Të evidentohet me kryeradhë shënimi që ka të bëjë me përmbajtjen e veprës nga shënimi mbi të dhënat bibliografike (*mbi autorin, vendin, vitin e botimit, ribotimet e ndryshme etj.*) që është pjesë e përshkrimit bibliografik.
- f. Adnotimi mundësisht duhet të bëhet me fjali mungesore dhe të pa plotësuar gramatikisht. Ato duhet të fillojnë me gërmë të madhe e të përfundojnë me pikë.

### 4. Përfaqja e punimeve bibliografike albanologjike me bibliografitë analitike

Përpyekjet e para në hartimin e këtyre lloj bibliografish i kemi në bibliografinë Albanica të autorëve Aldo Çoba e Zef Prela më 1965, u vazhdua më pas me botimin e Albanica –s II, ribotimin e plotësuar dhe të përmirësuar të Albanica-s I dhe një numër bibliografish të tjera albanologjike si: “Vendbanimet ilire dhe shqiptare”, “Lidhja shqiptare e Prizrenit”, “Shpallja e Pavarësisë” etj.

Puna për hartimin e këtyre bibliografive është mbështetur në standartet ndërkombëtare për përshkrimin e burimeve bibliografike, të transliterimit të alfabetëve të ndryshme e në hartimin e adnotimit mbi këto burime. Kryesisht adnotimet bibliografive albanologjike të hartuara deri tani, janë të llojit *Adnotim i kombinur*, pra me disa elemente të adnotimeve të tipeve, informues, sqarues por shpesh edhe interpretues e kritik. Për shembull:

#### Shembulli 1

*PIUS II, PAPA. Pii Secvndi Pont[ificis] Max[imi] Epistolae. De Conventu Mantvano [Letra të Papa Piuut II. Mbi Kuvendin*

*e Mantovës]. Opvs impressum Mediolani, Per Magistrum Antonium De Zarotis Parmensem, MCCCCLXXXIII [1473], Maii XXV. [179] fl.*

Të dhënat e botimit nga kolofoni. Botim i parë, tepër i rrallë dhe i kërkuar, sipas shënimit të dorëshkuar në fletën para titullit: M.r de Brun nella bibliografia istrutiva chiama prima edizione. Edizion [sic] très rare et fort recherchée. Edhe sipas Didos (NBU, 40, kol. 96-100) ky është botimi i parë i Milanos. Inicialja P e përbërë prej një medaljoni të portretit të papës, pikturuar në të gjelbër në fushë të kuqe. Në fletën e fundit të pashkuar shënimi i Mithat Frashërit: Giovanni Berruto. Torino. VII. 1941 marqué sur le catalogue 35 lire 3500; cioè paund 2,800 fr. or 450. Lumo Skendo.

Inkunabula, ndër më të hershmet e autorit, është më e vjetra e koleksionit antikuar të dhe përmban pesëdhjetë e dy letra të papa Piuut II (Enea Silvio Pikolomini, emri i autorit para se të zgjidhej papë), drejtuar disa personalitetëve të kohës dhe princërve të krishterë. Pikërisht ndër letrat e kësaj përmbledhjeje gjenden disa që lidhen drejtazi me përfshirjen e Arbërisë në projektin e kryqëzatës kundër turqve osmanë si dhe me qëndresën e Skënderbeut. Ato shërbejnë për të dëshmuar se 1459a, posaçërisht në kontingjencat e Kuvendit të Mantovës, ishte një vit interesimi nga ana e Piuut II për Skënderbeun dhe për Arbërinë, në vështrimin e rëndësisë luftarake, por jo vetëm. Në të përfshihet për herë të parë letra që papa i shkruante Mehmetit II (fl. 2, 67, 103, 121, 151, 153-154, 159, 163, 164, 169, 177). Armëpushimi midis Skënderbeut dhe sulltan Mehmetit II (fl. 154).

#### Shembulli 2

*CAESAR, CAIUS JULIUS. C[aii] Ivlii Caesaris commentarii, Scholijs & annotationi-bus D. Henrici Clareani illustrati, cum indice nouo, & alijs, quae sequens pagella do-cabit [Komentarë të Kaj Jul Cezarit me shënime dhe me ilustrime nga z. Henrik Klarean, me tregues të ri etj., të cilat do t'i sqarojë libri në vijim]. Venetis, MDXXXIX [1539]. [33] fl. me il., 511 f., [31] fl.*

Vepra përmban dy komentarë të Cezarit: De Bello Gallico [Mbi luftën galike] dhe De Bello civili [Mbi luftën civile].

Iliria dhe qytetet e saj, Dyrrahu (Dyrrachium), Apolonia, Oriku, Lisi (Lissus) dhe Butrinti (Buthrotum), gjatë luftërave midis Cezarit dhe Pompeut (f. 315, 317-322, 328-332, 337-338, 344-346, 348, 356-359, 362, 371, 410). Pirustët në luftë kundër Cezarit (f. 93-94).

Adnotimet e këtyre dy shembujve janë të tipeve informues-përshkrues, sqarues dhe interpretues.

Ashtu siç shihet dhe nga shembujt, bibliografia analitike albanologjike është një burim i pazëvendësueshëm informacioni, për punën shkencore të studiuesve. Në adnotimin e çdo njësie bibliografike jepen numrat e faqeve për çdo problem të evidentuar që i korespondojnë të dhënave historike mbi Shqipërinë dhe shqiptarët. Adnotimet duhet të bëhen në shqip dhe në anglisht apo në ndonjë gjuhë tjetër, duke mundësuar kështu konsultimin e bibliografisë jo vetëm nga studiues shqiptarë, por edhe të huaj të interesuar. Në këto bibliografi njësitë përshkruhen de visu që do të thotë jo nga burime të tërthorta, por drejtpërsëdrejti nga botimet e shqyrtuara e të regjistruara. Ashtu siç thuhet në standart titulli dhe të dhënat e tjera bibliografike përshkruhen siç gjenden në frontespis. Në rastet kur fleta e titullit ka qenë jo e plotë dhe e

dëmtuar apo mungon, të dhënat janë marrë nga kopertina, parathënia, pasthënia, teksti dhe shënimet në fund të librit. Janë shfrytëzuar edhe burime të tjera të besueshme si enciklopedi e bibliografi të ndryshme, monografi, artikuj revistash etj. nga autorë të huaj apo vendas, të cilët janë renditur alfabetikisht në listën e referencave në fund të këtij punimi bibliografik. Nëse për shumë dhjetëvjeçarë burimet e informacionit kanë qenë librat dhe formati i shtypur në letër, tashmë ky përcaktim ka të bëjë edhe me informacion elektronik të pakushtëzuar, të pakufizuar dhe të pacensuruar e të qasshëm në çdo moment. Sot për veprat pa autorë dhe me pseudonime, përveç enciklopedive, bëhen konsulta nëpërmjet internetit me site dhe me katalogë online të njohur botërore.

Veprat në dorëshkrim, dokumente dhe letra të personaliteteve të ndryshme shqip dhe në gjuhë të huaj që trajtojnë çështje me rëndësi historike, gjuhësore, etnografike etj; meqënëse nuk ekziston një bibliografi e dorëshkrimeve, janë bërë pjesë e bibliografive të adnotuara albanologjike së bashku me librat. Për dorëshkrimet nuk ka ndonjë standard të veçantë ndërkombëtar të përshkrimit bibliografik, prandaj është e domosdoshme mbështetja në Standardet Ndërkombëtare të përshkrimit bibliografik të antikuarëve ISBD (A) (International Standard Bibliographic Description for Older Monographic Publications) dhe ISBD. (International Standard Bibliographic Description)

Si shembuj do të veçoja dorëshkrimin Arkanxhelos mbi Skënderbeun dhe dorëshkrimin e Françesko Bolicës mbi Sanxhakun e Shkodrës.

### Shembulli 3

ARCANGELO, F. *L'Albania combattuta. Tragedia morale; del Molto Revo<sup>do</sup>: Padre F. Arcangelo: Romano Minore: Oss<sup>te</sup> di S. Francesco [Shqipëria e sulmuar. Tragjedi morale e të nderuarit at F. Arkanxhelo, roman i Urdhrit të Shën Françeskut]. S. I, [shek. XVII?] [4] fl., 243 f., nga të cilat 1 fl. e bardha; [8] fl. të bardha.*<sup>4</sup>

Kodiku, me kapak lëkure, përmban edhe Intermedii të Arkanxhelos, me frontespice dhe numërtim faqesh më vete. Zef Skiroi (f. 93-109) përshkruan një ekzemplar tjetër të kodikut dhe jep njoftime për veprat dhe autorin e saj. Sipas tij autori i kësaj tragjedie ka vdekur në vitin 1637 dhe këtë vepër duhet ta ketë shkruar në vitet '600. Duket se Skiroi ka pasur në duar një ekzemplar tjetër të dorëshkrimit me 122 fletë, tri nga të cilat janë të bardha, të kopjuar prej frat Stefanit nga Ankona në vitin 1651. Për këtë na bind edhe fakti se ekzemplari i Zef Skiroit ka përmasa të tjera (20 x 16 cm) nga ai i Bibliotekës Kombëtare (15 x 10,5 cm).

Tragjedi në vargje, me pesë akte dhe prologun. Ngjarjet zhvillohen në kohën Skënderbeut, një nga personazhet kryesorë të tragjedisë, dhe të luftërave të tij kundër turqve në muret e Krujës.

### Shembulli 4

BOLLIZZA, FRANCESCO. *Descrizione di Scutari, Dolcigno et altri luogi per Francesco Bollizza. Fu scritta l'anno 1614. Copia tratta dall'Originale che si conserva nell'Archivio di Stato a Venezia; e da me fatta copiare [Përshkrim i Shkodrës,*

*i Ulqinit dhe i vendeve të tjera nga Françesko Bolica. U shkruajt në vitin 1614. Kopje e nxjerrë nga origjinali që ruhet në Arkivin e Shtetit në Venecia dhe e kopjuar me porosinë time]. S. I. 1614. [2] fl., 57 f.*<sup>5</sup>

Kopje pa datë e dorëshkrimit origjinal të vitit 1614. Shkrimi i porositësit i ndryshëm nga ai i kopjuesit të relacionit. Në fund: Copia tratta dall'originale esistente nel R. Archivio di Stato in Venezia Miscellanea Codici N. 254.

Të dhëna statistikore për sanxhakun e Shkodrës. Qytetet, fshatrat dhe pozita e tyre gjeografike. Të dhëna demografike dhe etnografike për banorët e këtyre trojeve. Ekspedita turke të viteve 1612-1613 kundër malësorëve shqiptarë të këtij sanxhaku (f. 1-55). Të dhëna dhe për vitin 1699 (f. 56).

Ndërsa për sa u përket dorëshkrimet orientale ato kanë përmbajtje fetare, juridike, historike, gjuhësore e letrare etj. Vlen të veçohen veprat letrare të dorëshkruara në gjuhën shqipe me alfabet arab, sidomos divanet. Vlerësohen posaçërisht mynsheatet osmanisht ose krestomacitë dokumentare (përmbledhje letrash private dhe shkresash zyrtare), një pjesë e të cilave me të dhëna për historinë e Shqipërisë dhe të qyteteve të saj. Shumica e dorëshkrimeve orientale u takon shekujve XIII-XIX. Mungesa e një standardi ndërkombëtar të veçantë për transkriptimin dhe përshkrimin bibliografik të dorëshkrimeve orientale, ka bërë që sot qendra të ndryshme bibliografike të përdorin disa sisteme të transkriptimit të tekstit. Më afër sistemit grafik të shqipes është mënyra e transkriptimit që përdor Biblioteka e Kongresit në SHBA.

### Shembulli 5

MÛNŞEAT [Modele letrash e shkresash]. 1219 h. [1804]. 225 f.

Dorëshkrim i kopjuar nga Ymer Mustafa Kashari me një parathënie, ku përmenden edhe autorët e letrave nga Shkodra, Tirana dhe Elbasani. Anash tekstit një fjalor arabisht-osmanisht.

Njoftime të shkurtra për ngjarje të ndryshme në krahinat e Tiranës, Elbasanit, Shkodrës dhe Durrësit në fund të shek. XVIII dhe në fillim të shek. XIX. Marrëdhëniet agrare në krahinën e Tiranës. Feudalët tiranas, marrëdhëniet ndërmjet tyre, me feudalët e tjerë të vendit dhe me Portën e Lartë (f. 20, 21, 23, 25, 28, 67, 110, 196, 199). Pashallarët e Elbasanit dhe Ahmet Kurt Pasha (f. 30-49). Gjendja politike në pashallëkun e Shkodrës dhe rebelimi i Karamahmut pashë Bushatlliut (f. 106, 118). Marrëdhëniet agrare në krahinën e Durrësit (f. 198). Adnotimet e këtyre shembujve të dorëshkrimeve që përmendëm më sipër janë të tipeve informues-përshkrues dhe sqarues.

Mjaft e rëndësishme në bibliografitë e analitike është ruajtja përgjatë gjithë punimit e një strukture përshkrimi për elementët bibliografik. Kështu për shembull, emrat e autorëve në kryetitull shënohen në formën e tyre origjinale dhe të njësuar, pavarësisht si gjenden në fletën e titullit të veprës që përshkruhet. Emrat e autorëve të përkthyer në gjuhë të tjera përshkruhen në formën origjinale të gjuhës së autorit. Autorët e veprave anonime si dhe autorët që kanë përdorur pseudonime ose iniciale, shënohen në kryetitull me emrin e tyre të vërtetë, kur është bërë i mundur identifikimi, duke

<sup>4</sup> Albanica: bibliografi e shekujve XV-XVIII/ Mema, Sh.; Sharxhi, A., Biblioteka Kombëtare, Tiranë, V.1, 566 f. me il, 1998, vep. e cituar f.

<sup>5</sup> Po aty, f. 165



dhënë edhe burimin përkatës. Autorët sllavë, grekë, osmanë dhe titujt e veprave të tyre në original, janë transliteruar sipas rregullave dhe standarteve ndërkombëtare.

Në fund pas renditjes kronologjike të njësisve bibliografike, vendosen ilustrimet nga veprat që përfshihen në këtë bibliografi me një numërtim të ri bibliografik, dhe me renditje kronologjike. Ilustrimet nga veprat që përfshihen në bibliografi mund të jenë:

- vendbanimet;
- mjedise gjeografike;
- figura historike;
- portrete;
- tablo;
- veshje shqiptare;
- kështjella dhe kala;
- objekte arkitekturore;
- mbetje arkeologjike;
- objekte kulti;
- harta.

Bibliografitë e analitike albanologjike pajisen me tregues të shumtë të cilat mund të jenë:

- treguesi i autorëve të veprave;
- i titujve të veprave pa autorë;
- i vendeve;
- i emërtimeve lëndore;
- i autorëve të hartave;
- i vendeve të hartat;
- i titujve të hartave pa autorë;
- i vendeve të hartat;
- i autorëve të ilustrimeve;
- i titujve të ilustrimeve;
- i titujve të ilustrimeve;
- i personave tek ilustrimet;

## 5. Përfundime

Analiza e ndërtimit të një bibliografie analitike albanologjike bëhet në mënyrë që studiuesit të marrin informacion të sistemuar e kronologjik mbi veprat më të rëndësishme shkencore albanologjike. Nëpërmjet hartimit të veprave bibliografike analitike lehtësohet mundësia e konklutimit dhe hulumtimit të njësisve me vlera të çmuara historike dhe filologjike mbi qytetërimin e popullit shqiptar.

## 6. References

1. Albania: bibliografi e shekujve XV-XVIII/ Mema, Sh.; Sharxhi, A., Biblioteka Kombëtare, Tiranë, V.1 1998.
2. International Standart Bibliographic Description for Older Monographic Publications (Antiquaria). Ed. By International Federation of Library Associations and Institutions, IFLA/Universal Bibliographic Control and International MARC Programme, Series 3.
3. Tillett B. What is FRBR: A Conceptual Model for the Bibliographic Universe. Library of Congress Cataloging Distribution Servis, 2014.
4. Konferenca e pare e studimeve albanologjike:15-21 Nëntor 1962, red. Androkli Kostallari, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, 1965.
5. Welsh, A.; Batley, Sue. Praktikal Cataloguing: AACR2, RDA and MARC 21, Chicago: Neal-Schuman. 2012; 16.